



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-27152 /25

Klinë, dt: 19.08 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 09.07.2025, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti drejtorët, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit. Komiteti për Politikë dhe Financa, përveç shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, si pika shtesë në rend dite shqyrtoi:

- 1. Propozimin për ndarjen e mjeteve buxhetore për ndërtimin dhe rindërtimin e ashensorëve në 3 objekte banesore;**
- 2. Propozimin për transfer të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21).**

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

- 1. Arsyetimi i mungesave;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2025 (ref.drejt.fin);**
- 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt qershor-korrik 2025;**
- 5. Të ndryshme.**

Fadil Gashi, kryesues: Mirë se keni ardhur në takimin e rregullt të KPF-së. Besoj që ftesën me material e keni marr. Për momentin jemi gjashtë anëtarë. Fjalën ia kaloj zyrtares së lartë

financiare, znj. Melihate Behramaj, që të sqarojë pikat shtesë.

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Ju përshëndes fillimisht. Dje kemi pasur një kërkesë nga banorët e ndërtesës “Mirusha” te hekurudha për rindërtimin e liftit. Ata janë organizuar mirë dhe kanë ardhur shumë të organizuar, me participim dhe gjithçka. Kjo është një kërkesë e vjetër, sepse kemi pasur edhe ndërtimin e liftit të banesës “Rafi”, dy lifte. Fillimisht, na është përgjigjur vetëm njëra hyrje, sepse për të ndërtuar një lift duhet të ketë participim nga qytetarët. Na ka munguar organizimi i qytetarëve për të thënë që mund të kontribuojnë me 30%. Përderisa është KPF-ja sot dhe dihet që në gusht nuk ka pasur seancë, dhe në shtator mund të ketë një seancë më të hershme, ne kemi shfrytëzuar rastin dhe kemi përgatitur shkresat për t’u shqyrtuar në KPF. Kërkesa e parë është shtim buxheti, dmth participimi i qytetarëve për këta tre lifte, sepse bëhet fjalë për liftin e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, që sipas tyre rindërtimi kushton 6,000 euro, dhe 30% e tyre është 1,800 euro. Rindërtimi i liftit të banesës “Mirusha” te hekurudha, hyrja e parë, dhe ndërtimi i liftit të banesës “Rafi”, për njërën prej hyrjeve, nuk e di saktësisht. Ne jemi të obliguar të kontaktojmë dje me banorët e banesës “Rafi” për t’u zotuar se ata do të kompensojnë pjesën e tyre. Kërkesa e dytë është shtimi i buxhetit për participimin dhe transferimi i mjeteve nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për bashkëfinancim për donatorë, për të realizuar liftet, pasi pjesëmarrja jonë është mbi 41,000.00 euro, dhe pjesa e tyre është 14,100.00 euro për tre lifta.

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Dua të lidhem me pyetjen që e diskutoi Meli, por dua t’ju bëj një pyetje; përveç liftit që është ndërtuar apo nuk ka funksionuar. Ka kaluar pothuajse një vit që Shoqata e Veteranëve nuk është marrë me këtë çështje. Gjatë fushatës erdhën në fund dhe e gjetën me ngut për shkak të përfitimit të votave, por pse nuk e kanë marrë parasysh kërkesën e tyre për një vit? Unë nuk pajtohem me këtë, të mbetet për herën tjetër.

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Për këtë pyetje nuk kam sqarime, sepse nuk di si është puna. E di vetëm që banori i ndërtesës “Mirusha” ka qenë iniciatori i parë, pastaj u grumbulluan edhe këto dy kërkesa. Për tjetër gjë nuk di.

Asdren Ramadani: Kërkoj falje, por dua të ndërlidhem me këtë temë. Nuk po të akuzoj ty për asgjë, por është problem që nuk është marrë parasysh kërkesa e tyre për një vit. Edhe unë jetoj afër aty.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit. Na është sjellë një kërkesë që prej një viti për “Rafin”. E kemi proceduar, madje e kemi debatuar dhe miratuar buxhetin për këtë vit. Mund të fillojnë procedurat për objektet tjera, por unë nuk kam informacion për to deri më tani. Sot po e marr këtë informacion. Por kërkesat zyrtare janë për “Rafin” për dy hyrjet, dhe i kemi shqyrtuar dhe mbështetur. Tash për momentin është vetëm për një hyrje, jo për dy.

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Sepse qytetarët nuk kanë qenë në gjendje të participojnë edhe për hyrjen tjetër. Sepse pa participuar, ne nuk mund të bashkëfinancojmë me askënd.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush tjetër?

Blerta Gashi: Unë mendoj që duhet të vazhdojmë, pasi Meli veç sqaroi arsyen.

Fadil Gashi, kryesues: Kalojmë te rendi i ditës? A pajtoheni me rendin e ditës?

Me 6 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi kryesues: Ende jemi duke e pritur Tunë Dedën, të tjerët jemi prezentë.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: Për procesverbal nëse ka dikush?

Me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar – qershor 2025.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, referoi zyrtarja kryesore financiare, **znj. Melihate Behramaj**, e cila theksoi se Raporti për periudhën janar-qershor 2025 është përgatitur në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L – 048. Buxheti sipas SIMFK për vitin 2025, duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe të jashtme, është 16,238,141.93 €. Buxheti për këtë periudhë është më i lartë për 6.57% se buxheti i vitit 2024. Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 13.73% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria ekonomike e shpenzimeve komunale, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve dhe kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale. Po ashtu prezantoi të hyrat buxhetore të Komunës së Klinës për vitin 2025, duke përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit, sipas tabelës:

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2025	% në total	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2024	Ndryshimi 2025/2024 në %
Granti qeveritar	14,673,149.00	90.36	13,212,457.00	11.06

Të hyrat vetanake	1,495,504.00	9.21	1,436,260.00	4.12
Të hyrat e bartura	-	-	518,152.50	(100.00)
31- Granti i donatorëve të brendshëm	48,572.59	0.30	48,757.99	(0.38)
32- Granti i donatorëve të jashtëm	18,341.33	0.11	18,341.33	-
61- Granti i jashtëm (Performancës)	2,575.01	0.02	2,575.01	
TOTALI	16,238,141.93	100.00	15,236,543.83	6.57

Asdren Ramadani: Sa i përket raportit të shpenzimeve, desha të ndalem te shpenzimet telefonike. Dallimi me vitin paraprak është 2,270.00 euro. Pastaj, te furnizimi me ushqim, që është diferenca për gjashtëmujorin, dmth 35,468.00 euro, që është 19,267.00 euro më shumë se vitin paraprak. Po ashtu te drutë, ku dimë që shumica kanë filluar tashmë me pompa termike, diferenca me vitin paraprak është 6,600.00 euro më shumë dru: 48,000.00 euro këtë vit në gjashtëmujorin e parë, ndërsa në gjashtëmujorin paraprak ishte 42,000.00euro. Pastaj te mirëmbajtja e pajisjeve dhe mobiljeve, dmth 56,000.00 euro në këtë gjashtëmujor, ndërsa në gjashtëmujorin paraprak ishin 13,321.00 euro, që bën diferencë prej 43,047.00 euro. Tjetra janë shpenzimet e gjykatës: vitin paraprak nuk ka pasur asnjë shpenzim, ndërsa tani 46,900.00 euro janë marrë nga gjykata. E njëjta situatë është me shpenzimet komunale, ku besoj se janë shpenzimet për rrymë, ujë dhe mbeturina. Mbeturinat janë po ashtu si vitin paraprak, por diferenca në shpenzime shihet dhe është e lartë, 121,516.00 euro. Te vendimet gjyqësore, në vitin paraprak nuk ka pasur asnjë shpenzim, te vendimet gjyqësore, në vitin paraprak nuk ka pasur asnjë shpenzim, ndërsa vetëm në gjashtëmujorin e parë janë 86,900.00 euro. Te trotuaret këtu, me punën në terren që është duke u bërë, nuk po e di sa shfrytëzohet ai trotuar, sepse të gjitha shtyllat janë në rrugë dhe qytetari nuk po e shfrytëzon. Nuk e di pse gjithë ky shpenzim kot nëpër trotuar, a vetëm pse po jepen tendera apo ku është problemi?

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Kështu, te shpenzimet e telefonisë mobile vala 900 është shumë e vërtetë që është kjo rritje, por këto janë borxhe të mbartura. Mund të dokumentoj me fatura për secilën drejtori që ka pasur borxhe të papaguara të vitit të kaluar, dmth një drejtori ka pasur 700 euro borxh të papaguar të vitit të kaluar dhe nuk ka pranuar me i paguar pa u barazuar me kompani. Pas raportit jemi barazuar me kompani dhe janë paguar këto borxhe. Tek furnizimi me ushqim dhe pije, unë edhe më herët e kam treguar që është borxh i mbartur prej 22,217.00 euro nga furnizimi me paketa ushqimore të Vitit të Ri, dhe ato hyjnë në këtë kod 13/620, sepse nuk ka pasur ndonjë shpenzim të dallueshëm prej vitit në vit. Tek furnizimi me dru është e njëjta qasje, nuk është ndonjë shpenzim shumë më i madh, por te pagesat e shkollave mund të verifikoj faturat se në cilën datë kanë ardhur drutë dhe kur janë paguar. Është borxh i

bartur, çdo vit bartet borxh kur nuk ka buxhet të mjaftueshëm. Te mirëmbajtja e pajisjeve dhe mobiljeve, edhe këtu e di rastin ku është bërë shpenzimi më i madh në gjimnaz, janë ndërruar komplet radiatorët që i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, sepse u hoqën disa dhe u vunë të tjerë për të kaluar me pompa termike, që nuk di nëse ka ndonjë kontratë ende lidhur me këtë. Te shpenzimet e vendimeve me gjykata, këto janë prej kontratës kolektive, edhe nëse i kemi milionat në kategorinë e pagave, pagesat e shpenzimeve të kontratave kolektive nuk na lejojnë me paguar në formë të rregullt. Gjithçka shkon me përbarim, përbaruesi ka parë mjetet e lira këtu dhe i ka marrë. E njëjta gjë është edhe me subvencionet, i ka marrë përbaruesi për kontratat kolektive. I kemi listat me përfitues, kush sa ka marrë prej kontratës kolektive. Te vendimet gjyqësore, te kategoria e mallrave dhe te kategoria e subvencioneve, dmth te 55-shi dhe 60-shi, janë komplet të kontratës kolektive. Te 73-shi, nëse nuk kërkoje sqarim, është kontrata kolektive. Është toka, është stacioni i autobusëve që është në kontekst prej shumë vitesh. Nuk e di nëse është edhe fatura e Shkodranit, dmth 45,000.00 euro. Te trotuarët është vlera shumë më e madhe, është shumë e vërtetë. Kjo del prej planit kontabël, sepse vitin e kaluar në çdo trotuar dhe rrugë e kemi vendosur në kodin e rrugëve lokale, dmth e kemi zotuar dhe e kemi paguar me kodin ekonomik 31/230 që i takon kodit të rrugëve. Me rekomandim të auditorëve, sivjet jemi duke bërë një shpërndarje më të drejtë të pagesave, edhe pse edhe vitin e kaluar nuk ka qenë gabim. Nuk na kanë gjetur materialitet, por na kanë rekomanduar që të shkojë më mirë të ndahet nëpër kode, sepse zyrtarja e pasurisë edhe vitin e kaluar i ka klasifikuar nëpër kode të duhura, por me rekomandim të tyre kemi nisur t'i shpërndajmë nëpër kode ekonomike adekuate. Sa i përket punëve, siç tha edhe kryesuesi, unë nuk mund të jap përgjigje përse është vlera më e madhe. Kjo është me rekomandim të auditorëve që shpenzimin e klasifikojmë në kodin e duhur. Një kontratë nëse është 200,000.00 euro, për zotimin e vjetër kërkojmë dokument sa me i zotuar trotuarët, kanalizimet, rrugët, për shkak të zanit në plan kontabël.

Fadil Gashi, kryesues: Po, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues. Kryesues, krejt në rregull, por unë s'isha pajtuar me raportin, sepse thatë ku kanë shkuar shpenzimet te shkollat dhe të këto. Pse atëherë nuk i specifikoni që është bërë ndërrimi i radiatorëve etj.? Po dmth që i vendosni të gjitha në një vend. Edhe një arsytim që e bëtë rreth furnizimit me ushqim, drekave, sa ka qenë ai shpenzim rreth pakove për Vitin e Ri që i kemi marrë ne?

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: 22 mijë e diçka euro.

Asdren Ramadani: Në rregull, po na po shihet që të gjitha këto janë borxhe, gjithë këto që i kemi borxh në vit, po edhe ato të vitit paraprak. Atëherë na duhet të dëshmojmë se çfarë kemi paguar ose çfarë kemi shpenzuar. Dmth, 90% po shihen borxhet e vitit paraprak.

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Te mbeturinat, se mbeta borxh aty, e keni në pasqyrat financiare. Është borxh rreth 28 mijë e diçka euro. Në pasqyrat financiare mundeni me pa gjithçka, edhe borxhin që ka mbetur, sepse është komplet fatura, komplet borxhi. Çdo vit mbetesh borxh sepse edhe nëse ti ke buxhet deri me 11 nëntor, më nuk ke mundësi me zotuar mjete. Dmth, ne kemi pasur një fat të mirë që nuk kemi shkuar në deficit, por ndodh që të shkojë në deficit dhe të mbeten faturat borxh. Nëse obligimi krijohet pas 11 nëntorit dhe nuk e planifikon, nuk e zoton më herët, ai automatikisht mbetet borxh. Duke u bazuar në përvojën tonë,

çdo vit paguhet një pjesë e borxhit të vitit të kaluar, patjetër që do të mbetet prapë borxh në fund të vitit. Sa u përket borxheve, janë drejtoritë që duhet të japin sqarime rreth menaxhimit të buxhetit. Sa i përket sqarimeve për radiatorë e këto, unë do ta komplotoj këtë raport dhe do ia dorëzoj krejt asamblistëve, siç ju është dorëzuar edhe në mbledhjet e fundit të seancave.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, po është një detaj tjetër. Mos harroni që ne e kemi rregulloren për grumbullimin e mbeturinave dhe i kemi rritur tarifat. A e dini? Po të kjo Shkodrani, mua më intereson diçka.

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Për Shkodranin, tash nuk jam e sigurt nëse ai përmbartim ka hyrë në gjashtëmujorin e parë. Ka pasur borxh te kanalet e ujitjes në Gllarevë, më duket që është prej dy-tri vitesh, ose furnizim me ujë të pijes, mund ta shikoj më mirë. Nuk ka pasur projekt për me u paguar ai borxh. Ka qenë me MAPL-në, dhe kur erdha unë në 2023-tën, më ka ardhur ky borxh. MAPL-ja kishte obligim të paguante 50,000.00 euro, por Shkodrani nuk i ka përfunduar punët para Vitit të Ri, kështu që zyrtarët tanë nuk ja kanë pranuar punën. Pas Vitit të Ri MAPL-ja nuk e ka paguar, ne nuk kemi pasur projekt me emër të tillë dhe kemi mbetur pa e paguar. Kjo është arsyeja.

Fadil Gashi, kryesues: E si është paguar tash?

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Puna ju ka pranuar në prillin e vitit 2023, dmth situacioni përfundimtar është pranuar teknikisht në prill të vitit 2023, kur ne nuk kemi pasur projekt për të paguar atë borxh. MAPL-ja nuk e ka marrë përsipër borxhin.

Fadil Gashi, kryesues: Dikush tjetër?

Asdren Ramadani: Vetëm një kërkesë: kur të na vijë materiali për seancë, a ka mundësi me i specifiku më detajisht dhe më qartë çdo shpenzim për seancë?

Fadil Gashi, kryesues: Bëhen shumë. Nëse i referohemi trotuareve, ne e kemi miratuar buxhetin, i kemi projektet e miratuara, edhe vetë shkojmë duke parë cilat trotuare janë ato.

Asdren Ramadani: Po pajtohem me atë që po thuani ju, po p.sh. rreth radiatorëve dhe shpenzimeve të tjera.

Fadil Gashi, kryesues: Kur ta miratojmë buxhetin, aty ka investime, për cilat shkolla investohet në radiatorë, kaldaja, etj.

Melihate Behramaj, zyrtare e lartë financiare: Është një detaj mjaft i madh, sepse për datën sa unë duhet me dërgua raportin, është e pamundur t'i bëj të gjitha ato sqarime. Merr kohë. Unë mundem të nxjerr një kartelet analitike ku mund të shihni secilin transaksion, nëse kërkohet nga kryesuesi, unë mund ta bëj atë. Përndryshe, sqarime të tjera më 3-4 të muajit është e pamundur për mua.

Fadil Gashi, kryesues: Ne kemi pasur praktikë, Drejtoria e Financave mund t'i ndajë sipas drejtorive shpenzimet. Le të bëhet ndarja sipas drejtorive dhe kur vjen Drejtoria e Arsimit, ose

Bujqësisë, ose drejtoritë tjera, ti i sheh shpenzimet se ku kanë shkuar. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2025, me 6 vota PËR, rekomandoi që shpenzimet të ndahen veçmas për çdo drejtori me rastin e shqyrtimit të raportit në Kuvend. Po ashtu, Komiteti rekomandoi që raporti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt qershor-korrik 2025.

Kërkesa 1

Kërkesë e parashtruar nga z. Fadil Bashota nga fshati Caravik i Komunës së Klinës, me anë të së cilës kërkon rrethimin me stuba të betonit të varrezave të lagjes “Bashota” dhe një pjesë të lagjes “Gashi” nga fshati Çabiq.

Fadil Gashi, kryesues: Unë po e konstatoj se e kemi edhe sivjet në buxhet. I keni parë rrethojat nëpër varreza. Është mirë me ia dërguar Drejtorisë për Urbanizëm, le ta merr, le ta shqyrtojë, dhe le të jetë pjesë e këtyre projekteve të përgjithshme, rrethojave të varrezave. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Fadil Bashota, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe të shikohet mundësia për inkorporim në radhët e projekteve me prioritet për vitin 2026, me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2026.

Kërkesa 2

Kërkesë e parashtruar nga HANDIKOS, kryetare Vjollca Preka, me anë të së cilës kërkon nga Asambleja Komunale në Klinë që t’i vihet në dispozicion një objekt adekuat për shfrytëzim afatgjatë, në të cilin do të mund të zhvillojë aktivitetet e shoqatës dhe të ofrojë shërbime të domosdoshme për personat me aftësi të kufizuara.

Arsyetim: Shoqata aktualisht nuk ka objekt funksional, gjë që e pamundëson ofrimin e shërbimeve bazë. Kërkon që kjo çështje të trajtohet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë, dhe t’i jepet një përgjigje zyrtare mbi mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjes. Objekti duhet të ketë:

- Një zyrë 20 m²
- Një sallë për takime dhe trajnime të ndryshme 25 m²
- Një depo për mjete ortopedike dhe sanitare 20 m².

Fadil Gashi, kryesues: Ne i kemi trajtuar jo njëherë kërkesat e kësaj shoqate, por është një shkresë tepër zyrtare. Nuk është që nuk kemi ndjeshmëri për këtë kategori, por është infrastruktura ligjore që edhe neve, si ata që janë të hendikepuar, na vë në situatë të vështirë për të marrë vendim për ndarjen e hapësirës. Ju e dini që ndarja e hapësirave bëhet me thirrje publike dhe dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike e pronës së paluajtshme; ne nuk mund t'i japim pa ankand. Nëse s'gabo, nuk e di saktë, por te objekti "Noitra" kemi bërë disa përpjekje dhe e kanë përsëritur, por nuk vjen askush me marrë me shpallje; nuk ka procedurë si t'ia japim. Madje, ky nuk është vetëm një zyrë, janë tri objekte të bashkuara, dhe është pak telashe për t'i gjetur. Tani mund të krijohet përshtypja që ne si kuvend nuk po gjejmë gatishmërinë apo nuk kemi ndjeshmërinë e duhur, siç duket nga shkresa që na kanë dërguar, por nuk është kështu. As unë e as anëtarët e tjerë të kuvendit nuk e mendojmë kështu; problemi qëndron në pengesat ligjore që na pengojnë të ndajmë hapësira pa respektuar procedurat. Për këtë arsye është mirë që kur ta artikulojmë këtë, unë jam i gatshëm të takohem edhe fizikisht me ta. Ne kemi qenë shumë korrektë dhe u kemi përgjigjur disa herë, por jemi në situatë të vështirë për të dhënë hapësira publike pa respektuar procedurat ligjore. Unë nuk dua ta shtyj më tej, por u jap secilit prej jush të drejtën të angazhoheni dhe të na ndihmoni se çfarë mund të bëjmë për ta zgjidhur këtë. Nuk na mungon vullneti, por nuk kemi rrugë tjetër. A ka dikush? Po, Asdren?

Asdren Ramadani: Faleminderit. Kryesues, kjo kërkesë është shumë e rëndësishme, dhe ne me gjithë dëshirën e madhe e përkrahim. Por, duke e analizuar situatën dhe duke e kuptuar sqarimin tuaj shumë mirë, nuk jam i sigurt se sa mundësi kemi për t'ua dhënë hapësirat, sepse jemi të hendikepuar siç e sqaruat. Pra, nuk dimë as ne çfarë vendimi tjetër mund të marrim ndryshe. Faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: Dikush tjetër? Po, Mendehie?

Mendehie Duraku: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Desha vetëm një sqarim, kryesues: këto thirrjet për ankand, të gjitha kërkesat që kemi pasur deri tani, a ka ndonjë që është realizuar deri tash? A ekziston kjo praktikisht, apo vetëm po flasim për këtë? A ndodh që dikush t'i marrë pronat me shpenzim? Faleminderit.

Fadil Gashi, kryesues: Nuk jam 100% i sigurt, por aq sa di unë, kemi pasur vendim për t'i dhënë në shfrytëzim këto hapësira. Njëherë kemi ndryshuar destinimin e hapësirave që kanë pasur. E di që ka pasur një thirrje publike për t'i dhënë, por nuk ka aplikuar askush për t'i marrë. Por nuk ke mundësi të ndryshosh shumë, sepse këto janë organizata joqeveritare. Dhe për t'ua dhënë ato duhet të paguajnë qira, por ata nuk duan të paguajnë qira, dhe ky është problemi. Mund të kemi hapësira, por problemi është si t'ia gjejmë formën që të mos i detyrojmë të paguajnë qira. Të japësh hapësira pa ndonjë obligim ligjor është shkelje ligjore dhe nuk u ndihmon as atyre, as ekzekutivët. Kjo është dilema: si të gjejmë mënyrën për t'ua dhënë?

Mendehie Duraku: Po kryesues, a mundemi ne t'u dërgojmë një shkresë atyre për t'ua sqaruar se nuk lejohet ashtu siç po mendojmë?

Fadil Gashi, kryesues: Tash për tash nuk e di, por di që kemi tentuar ta sqarojmë me një shkresë, madje kam tentuar edhe të komunikoj fizikisht me ta. Por kjo le të mbetet për seancë. Kështu që kemi komplet ekzekutivin dhe kuvendin dhe në njëfarë mënyre dua që kur të bëhet debati i plotë në seancë, të përmbushet kjo kërkesë. Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Vjollca Preka, në cilësinë e kryetares së qendrës së Handikos-it, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

● **Propozimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për ndërtimin dhe rindërtimin e ashensorëve në 3 objekte banesore.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, zyrtarja kryesore financiare, **znj. Melihate Behramaj** theksoi: duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mjedisit, e dt. 08.07.2025, kërkojmë që të aprovohet kërkesa për shtim të buxhetit për projektin “Ndërtimi dhe rindërtimi i liftit në tri objekte banesore” nga participimi i qytetarëve, shuma prej 14,100.00 € (katërmbëdhjetë mijë e njëqind euro).

Fadil Gashi, kryesues: Tash ju mbetet juve të 4-ve të vendosni, unë me Blerten jemi për. Po, urdhëro, Blerina?

Blerina Gashi: Përshëndetje për të gjithë, unë kryesues nuk jam kundër ndërtimit të atij lifti sepse duhet të mendojmë pak për nevojat e qytetarëve. Vota ime nuk është kundër, për mua ajo çështje kalon.

Asdren Ramadani: Nuk jemi kundër, por problemi është që kërkesat kanë ardhur me vonesë dhe kanë lënë momentin e fundit. Ne jemi përkrahës dhe duam t’i ndihmojmë të gjithë qytetarët.

Blerina Gashi: Të njëjtën gjë e thash edhe unë, Asdren. Nuk jam pro që materiali ka ardhur me vonesë, por nuk jam kundër ndërtimit të liftit.

Fadil Gashi, kryesues: Po, Mendehie?

Mendehie Duraku: As unë nuk jam kundër që banorët kanë bërë këtë kërkesë dhe nuk jam kundër realizimit. Jam kundër shkresave që katër vite radhazi nuk janë dorëzuar në kohë nga asnjë drejtori. Nuk mund të vijnë pesë minuta para seancës ose gjatë seancës me kërkesë, e kemi thënë edhe disa herë. Për këtë arsye thash se jam kundër, jo kundër projektit për realizim për qytetarët. Faleminderit.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë për

Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me 6 vota PËR, rekomandoi që të ndahen mjete financiare edhe për ndërtimin e ashensorëve të tjerë, po ashtu rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

•Propozimi për transfer të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21).

Po ashtu, lidhur me këtë pikë referoi prapë zyrtarja kryesore financiare, e cila theksoi se propozimi i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim është transferi i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21).

Nga:

- Programi: Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180),
- Nënprogrami: Infrastruktura Rrugore (18018),
- Kodi funksional: (0451),
- Projekti: “Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Ranoc, Radulloç, Shtupel, Shtaricë etj.”,
- Kodi i projektit: 56127,
- Shuma: 50,000.00 €

Të transferohen në projektin:

- Programi: Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660),
- Nënprogrami: Planifikimi urban dhe Inspeksioni (66395),
- Kodi funksional: (0620),
- Projekti: “Bashkëfinancim me donatorë”,
- Kodi i projektit: 48267,
- Shuma: 50,000.00 €.

Arsyetim: Transferi brenda OB bëhet për harmonizimin e mjeteve për përfundimin e punëve sipas kontratave.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me 6 vota PËR, rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

5. Të ndryshme.

Pasi nuk pati ndonjë kërkesë apo sugjerim, kryesuesi e mbylli mbledhjen duke falënderuar të gjithë anëtarët për pjesëmarrjen dhe angazhimin.

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

Monika Palushi



**KRYESUESI,
Fadil Gashi**

Fadil Gashi